DALJE-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. 020 - 1281/5
-01-
Data 27.12.2019

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova-Republic of Kosovo

### Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | **Ragip Begaj**, Kryetar i Komunës së Malishevës<br>**Rrahim Morina**, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | **Adrijana Hodžić**, Ministre e MAPL-së<br>**Rozafa Ukimeraj**, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së | |
| Nga: | **Venera Çerkini**, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave | Datë:<br>23.12.2019<br>Nr.020-1281 |
| Zyrtaret përgjegjës:<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br><br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br><br>Ardita Latifi, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave | |
| Lënda: | Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Malishevës | |
| Lloji i aktit: | □ Vendim i Kuvendit të Komunës | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendim Nr. 02/697 - Miratohet kërkesa nr. 02/678 e datës: 12.12.2019 e parashtruar nga Lëvizja Vetëvendosje në Malishevë, për zëvendësimin e anëtarit në Komitetin për diasporë në Komunën e Malishevës nga radhët e Vetëvendosjes. |
| I miratuar më datë: 13.12.2019 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 18.12.2019 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural **<u>është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi</u>** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020 - 1281/5
~VI-
Data Datum Date 27.12.2019

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Za: | **Ragip Begaj, gradonačelnik opštineMališevo**<br>**Rrahim Morina, predsedavajući Skupštine opštine Mališevo** | |
| Kopija: | Jedinici za administriranje sa dokumentima u MALS-u<br>Jedinici za administriranje sa dokumentima u opštini | |
| Preko: | **Adrijana Hodžić**, ministarka MALS-a<br>**Rozafa Ukimeraj**, generalna sekretarka MALS-a | |
| Od: | **Venera Çerkini** rukovodioca Odeljenja za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS | Dana, 23.12.2019 Nr.020-1281 |
| Odgovorni službenici:<br>1. Službenik za potvrđivanje pravne procene<br><br>2. Službenik za izradu pravne procene | Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština<br><br>Ardita Latifi, viša službenica za monitorisanje opština | |
| Predmet: | Potvrda zakonitosti akta opštine Mališevo | |
| Vrsta akta: | □ Odluka skupštine opštine | |

Poštovani gradonačelniče,

Poštovani predsedavajući

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primio je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

| |
|---|
| Odluka br. 02/697 - za odobrenje zahteva br. 02/678 od dana, 12.12.2019 podnošen od strane Pokreta Samoopredeljenje u Mališevu za zamenu člana u Odboru za dijasporu u opštini Mališevo iz redova Samoopredelja |
| Usvojena dana, 13.12.2019 |
| Predložena na razmetranje u MALS-u dana, 18.12.2019 |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt u proceduralnom aspektu u saglasnosti za <u>odredbama zakonodavstva na snazi o lokalnoj samoupravi</u>.Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

HYRESE-ULAZNI
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data 18.12.2019
-01-020-1281

Kuvendi i Komunës
Nr. 02/697
Datë: 17.12.2019

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja d, nenit 40, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/15, qershor 2008), nenit 10 dhe 19 të Statutit të Komunës nr.01/871 të datës:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen -XI- (njëmbëdhjete) të mbajtur me datë:13.12.2019 merr ketë:

## VENDIM
## PËR ZEVENDESIMIN E ANËTARIT NË KOMITETIN PËR DIASPORË

1. Miratohet kërkesa nr.02/678 e datës:12.12.2019 e parashtruar nga Lëvizja Vetëvendosje në Malishevë, për zëvendësimin e anëtarit në Komitetin për Diasporë në Komunën e Malishevës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje.

2. z.Isuf Buzhala caktohet anëtar i Komitetit për Diasporë në vend te anëtarit të deritanishëm z.Hidajet Krasniqi.

3. Nga dita e miratimit të këtij vendimi z. Isuf Buzhala bëhet anëtar me të drejta të plota, në kohëzgjatje me mandatit të anëtarëve tjerë të Komitetit për Diasporë.

4. Ky vendim do të jetë pjesë përbërëse e vendimit nr.02/88 datë:10.04.2018 për emërimin anëtarëve të Komitetit për Diasporë.

5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, përmes kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Malishevës.

6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet:
Arkivit të Komunës
MAPL-së.
Anëtareve të Komitetit.

Kryesuesi i Kuvendit
Rrahim Morina

PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 12.12.2019
PRIMLJENO:

Nr.No.Br. 02/678

**REPUBLIKA E KOSOVËS**

KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

---

Për: **Kryesuesin e Kuvendit Komunal në Malishevë, Rrahim Morina**

Cc: **Kuvendi Komunal në Malishevë**

Nga: **Alban Kraniqi, Anëtar i Kuvendit Komunal në Malishevë**

Lënda: **KËRKESË për zëvendësimin (plotësimin) me një anëtar të ri të Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Komitetin për Diasporë në Komunën e Malishevës.**

**Malishevë, 12 Dhjetor 2019**

---

I nderuar,

Duke u bazuar në nenin 39 të Ligjit për Vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 mbi të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të kuvendit komunal, si dhe në ligjet dhe aktet nënligjore që përcaktojnë detyrat dhe obligimet e anëtarëve të Kuvendit Komunal, kërkoj:

Në cilësinë e anëtarit të Kuvendit Komunal në Malishevë dhe njëherit si shef i Grupit të Asambleistëve të Lëvizjes VETËVENDOSJE! në emër të subjektit politikë që përfaqësoj, kërkoj që të ndryshohet përbërja e Komitetit për Diasporë në Komunën e Malishevës. Më konkretisht kërkoj që anëtari i deritanishëm Hidajet Krasniqi, i nominuar më parë nga ne, të zëvendësohet me anëtarin e ri Isuf Buzhala.

Arsyeja e këtij zëvendësimi është nga se anëtari i deritanishëm nuk ka shprehë gatishmërinë e tij për të përfaqësuar subjektin tonë në këtë Komitet. Neglizhenca e tij dhe e përfaqësuesve tjerë ka bërë të pamundur funksionalizimin e deritanishëm të këtij komiteti. Po ashtu, anëtari i deritanishëm, Hidajet Krasniqi ka kohë që edhe zyrtarisht ka dhënë dorëheqje nga gjitha përgjegjësitë dhe detyrat që kishte brenda organizatës sonë.

Ndaj, zëvendësimi i tij dhe emërimi i Isuf Buzhalës në pozitën e anëtarit të Komitetit për Diasporë, konsideroj është i domosdoshëm në radhë të parë për vet punën dhe funksionalizimin e këtij komiteti, e sidomos tash ku më së shumti ka nevojë që të funksionalizohet ky komitet për faktin se ditët e diasporës po afrohen, andaj është e domosdoshme që puna dhe aktivitetet e këtij komiteti të vihen në shprehje tani.

**Duke ju falënderuar paraprakisht pres përgjigjeje sa më të shpejtë në këtë drejtim dhe aprovimin e kësaj kërkese.**

Me respekt,

Për kontakt: e-mail albankras@gmail.com

Nr. Tel: 044-191-534